



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:064467

Datë: 21.10.2019

Numri i dokumentit: 00660231

P.nr.981/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren Fitore Daci në çështjen penale kundër të pandehurit L.M me vendbanim në rrugën ... në Ferizaj, për shkak të veprës penale Rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.436-7/2018 të datës 21.11.2018, në praninë e prokurores së shtetit Albana Parduzi, si dhe të pandehurit L.M, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt. 21.10.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

L.M i lindur me ..., nga i ati G... dhe nëna B... e vajzërisë S..., me vendbanim në Ferizaj, rruga ... , i gjendjes së mesme ekonomike, i punësuar , Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës me numër të letërnjoftimit ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 01.10.2018 rreth orës 12:45, në rrugën ..., Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës “VW 1T”, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 53.1 të LRTRR-së ka rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinën e tyre, në atë

mënyrë që nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë, me të arritur në rrugën e Prekazit e humb kontrollin mbi timon dhe me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet murin e oborrit të Z.S me ç ‘rast pos dëmeve materiale në automjet lëndime të rënda trupore ka pësuar pasagjeri i tij A.J dhe atë gjendje pas hematomës epidurale në anën e djathtë temthore- mure të kokës, gjakderdhjes subdureale parketo oksipitale djathtas, aerocefalisë (prezenca e ajrit në kokë), kontruzionit hemorragjik në anën ë majtë të kokës dhe thyerjes multifragmentare në unazën e 7 të qafës dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore të rrezikshme për heton në momentin e shkaktimit të aksidentit, të përshkruar si në ekspertizën mjekoligjore dt. 07.11.2018.

me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 4 ,7, 8, 17, 23, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, dhe nenit 378 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2/dy/ viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

I dëmtuari A.J me vendbanim në rrugën ”E...” në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë euro/ si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumën prej 60.88 €uro /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit.

Obligohet i pandehuri që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me Aktakuzën P.nr.2122-6/18 të datës 21.11.2018 ka ngarkuar të pandehurin L.M nga Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me dt. 21.10.2019, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurorja e shtetit Albana Paruzi, lexoi aktin akuzues, dhe gjyqtarja pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 dhe përkundër paralajmërimit për nenet 325 dhe 323 të KPPK-së, i ofroi mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri L.M, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, i vjen keq, ndihet thellë i penduar, kërkon falje publike, premtan se në të ardhmen do të jete me i kujdesshëm në komunikacion, këtë vepër penale e ka kryer pa dashje dhe është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe e lut gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

I të dëmtuari A.J deklaroi se pasi që tani kam arritur moshën madhore deklaroj se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, kërkesën pasurore – juridike do ta realizoj në kontest civil, ngase familjarët e të pandehurit janë kujdesur për mua që nga dita kritike dhe të njëjtit janë treguar shumë të kujdesshëm.

Prokurorja e shtetit Albana Parduzi, me rastin e paraqitjes së mendimit të saj, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të pandehurin, pasi pranimi fajësisë është në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 248 si dhe provat materiale të shkresave të lëndës.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPR-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit si: Ekspertiza mjeko ligjore e Dr.M.G e dt.07.11.2018, raporti mjekësorë nga Qendra Emergjente në Ferizaj e dt,01.10.2018, Flete lëshimi me epi kriza i dt, 10.10.2018, raporti konzilar për trajtim jashtë institucionit shëndetësor publik i dt.12.10.2018, fletëleshimi i Klinikës së Ortopedisë dhe Traumatologjisë Lokomotore në Prishtinë, skica nga vendi i ngjarjes, fotografitë, deklarata e dëshmiatëve si dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese përkatësisht që në shqyrtimin fillestarë i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, kërkim faljen publike, kujdesin e treguar të tije pas ditës kritike ndaj palës së dëmtuar, vepra ka ndodhur nga pakujdesia, i dëmtuari ka qenë pasagjer i të pandehurit dhe nuk ka dëshmi se është i dënuar me vendim të formës së prerë, deklarimi i të dëmtuarit i cili nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet

qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale).

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL

P.nr.981/19 datë 04.11.2019.

Zyrtari ligjor

Burim Haxhidema

Gjyqtarja

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Numri i lëndës: 2018:064467
Datë: 21.10.2019
Numri i dokumentit: 00660231